REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.7.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Krenare Pirana-Kiseri (Udhëheqëse e Ekipit), Luljeta Ajazi dhe Ylber Sadiku.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 10

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 16

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 32

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 33

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 35


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmorr në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit të Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 28/09/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informatat e shpalosura në PVF në lidhje me pasuritë fikse dhe stoqet e barnave janë materialisht të nënvlerësuara. Përveq kësaj kishte keqklasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike në vlerë prej 297,171€.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe informatat jo të sakta rreth pasurive dhe stoqeve janë reflektuar në PVF dhe kanë ndikuar në theksimin e çështjes.	Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të informatave financiare në PVF 2016 (shih nenkapitullin 1.2)
Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigjja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet sigurojë që mangësitë e procesit të vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak të adresohen në mënyrë aktive dhe progresi në lidhje me to t'i raportohet menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 3 dhe 4).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.	Ministri duhet të inicojë një rishikim kritik ndaj aranzhimeve të qeverisjes, në mënyrë që të identifikohen ndryshimet e nevojshme për adresimin e dobësive të identifikuara nga auditimi dhe për ta përmirësuar efektivitetin e raportimit menaxherial dhe nivelin e llogaridhënies (shih çështjet 5, 6 e 7).
Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi të mëdha në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin , kompenzimin e pagave, dhe subvencionet.	Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 9 deri 21).
Si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate, regjistrat e pasurive fikse dhe ato të stokut farmaceutik nuk janë të besueshme dhe të sakta.	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të procedurave të brendshme të zbatuara për menaxhimin e pasurisë dhe stokut farmaceutik, për të gjetur pse kanë ndodhur dështimet, dhe për të përcaktuar masat që duhet ndërmarrë për adresimin e dobësive të procesit. (shih çështjet 22 dhe 23)

Përgjigja e Ministrit – auditimi 2015

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar pjesërisht me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vertetë në të gjitha aspektet materiale, të pranimieve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare MF nr.03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Shendetësisë dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informatat e shpalosura në PVF në lidhje me pasuritë fikse dhe stoqet e barnave janë materialisht të nënvlerësuara. Pasuritë kapitale janë nënvlerësuar për rreth 2,279,794€, dhe stoqet e barnave janë nënvlerësuar për rreth 1,320,592€.

Përveq kësaj kishte keqklasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike në vlerë totale prej 297,171€ (për detaje shih çështjen 8). Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të keqbuxhetimit të shpenzimeve, dhe pjesërisht për shkak të gabimeve gjatë procesimit të pagesave. Shpenzimet prej 117,397€ kanë qenë të buxhetuar në kategori të gabuara ekonomike. Opinioni jonë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i MSH-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke

përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 28/09/2015, është identifikuar një rrezik domethënës për PVF-të. Ky rrezik ka të bëjë me saktësinë e vlerës së stokut farmaceutik siç është theksuar në opinion më lart. Gjatë auditimit ne identifikuam rreziqe tjera domethënëse për PVF-të, që lidhen me keqklasifikimin e shpenzimeve dhe me regjistrat e e pasurive fikse të shpalosura në PVF. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat rezultojnë me modifikim të opinionit përfshirë theksimin e çështjes.

Rastet e lartëpermendura, kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për të adresuar rreziqet e paraqitura.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MSH kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me SNKSP dhe kërkesat tjera të kornizës së raportimit; dhe
- Kërkesat tjera relevante (përfshirë: kërkesat buxhetore; raportet tremujore, pasqyrat nëntëmujore; draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit, raportin vjetor për kontratat e nënshkruara, raportin vjetor të vetvlerësimit të organizatës, raportimin mujor për borxhet ndaj furnitorëve), etj.

Në kontekst të PVF-ve, përveç pikave që lidhen me rrezikun domëthënës, e që janë të shqyrtuara më lartë, ne kemi identifikuar gabime tek shpalosjet si në vijim:

- Vlera e shpalosur në PVF e pasurive kapitale me vlerë mbi 1,000€ (Shënimi 30, neni.16) është nënvlerësuar për 2,279,794€ (shih nënkapitullin 3.7.1);
- Vlera e stoqeve (Shënimi 32, neni.16) është nënvlerësuar për 110,851€, ndërsa stoqet e barnave janë nënvlerësuar për 1,320,592€ (shih nënkapitullin 3.7.2);
- Vlera e të arkëtueshmeve (Shënimi 34, neni.16) është nënvlerësuar për 58,000€ (shih nënkapitullin 3.7.3); dhe
- Vlera e detyrimeve (neni.15) është nënvlerësuar për 40,024€(shih nënkapitullin 3.7.4).

Të gjeturat më lart tregojnë që procesi i përgatitjes së PVF-ve është menaxhuar dobët. Kërkesat bazike të raportimit ishin plotësuar, por konsolidimi i PVF-ve lë vend për përmirësim, me fokus të veçantë tek shpalosjet në lidhje me pasuritë, stoqet, llogaritë e arkëtueshme, dhe obligimet e pa paguara. Të gjitha obligimet e tjera për raportim të jashtëm që nuk ndërlidhen me PVF-të ishin përmbushur plotësisht.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA dhe ZKF

Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet jo e plotë dhe e pasaktë. Kjo mund të jetë bazë për Modifikim të Opinionit përfshirë Theksimin e Çështjes.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 **Prioriteti i lartë** – Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithpërfshirëse për ti përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për ti adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe praktike për ti hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe për të siguruar vlerësimin e saktë të pasurive, stoqeve, detyrimeve dhe të arkëtueshmeve.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MSH-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MSH-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien e institucioneve që janë në vartësi të Ministrisë, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga MSH, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, janë të vendosura por nuk funksionojnë në mënyrë efektive.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MSH-së ka rezultuar në 24 rekomandime kryesore (4 nga rekomandimet ishin për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar - SHSKUK e cila nga viti 2015 funksionon si organizatë buxhetore e pavarur nga Ministria). MSH kishte përgatitur një plan veprimi për implementimin e të gjitha rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 2 rekomandime janë implementuar plotësisht; 6 janë adresuar por janë implementuar vetëm pjesërisht dhe 12 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse MSH nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të AP-së.

Rreziku Mos implementimi i rekomandimeve ka ndikuar që të përsëriten dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare, duke rezultuar në:

- shpalosje jo të sakta të informatave në PVF, si pasojë e procesit joefektiv të hartimit të PVF-ve;
- mangësi në praktikat e prokurimit dhe të klasifikimit të shpenzimeve;
- mangësi në lidhje me pagesat e bordeve, komisioneve dhe kujdestarive;
- mangësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve; dhe
- menaxhim të dobët të barnave dhe të pasurisë.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MSH më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Me gjithë ekzistimin e Strategjisë së Shëndetësisë Kosovare dhe disa strategjive që ndërlidhen me fusha të veqanta në sektorin e shëndetësisë, strategjia gjithpërfshirëse e zhvillimit dhe proceset e monitorimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe koston e plotë të strategjisë) nuk janë vendosur;

2. Nuk janë vendosur procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2; dhe

3. Harmonizimi në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit dhe përpilimi i raporteve në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MSH-së, që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse vështirëson edhe parashikimin e rreziqeve potenciale që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të institucionit. Kjo mund të reflektojë në shërbime jo cilësore të ofruara ndaj qytetarëve.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit të plotësimit të listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MSH operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

MSH ka një numër të "agjencive ekzekutive" të cilat kanë një autonomi të gjerë të veprimit. Këto janë: Agjencioni Kosovar për Produkte dhe Pajisje Medicinale-AKPPM, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik-IKSHP, Agjencia e Financimi Shëndetësor-AFSH, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut-QKTGJ etj PVF-të e tyre janë konsoliduar në PVF-të e MSH-së.

Çështja 5 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

E gjetura	MSH është përgjegjëse për një sërë aktivitetesh në fushat kyçe të shpenzimeve të hyrave si dhe të aktiviteteve tjera operacionale të adresuara përmes institucioneve/agjencive. Përgjegjësitë në mes MSH-së dhe Agjencive të saj përfshirë përgjegjësitë përkatëse të raportimit ishin të përcaktuara qartë por nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Derisa mangësitë e paraqitura gjatë procesit të konsolidimit të PVF-ve kanë rezultuar në shpalosjen jo të saktë të informatave rreth pasurive kapitale, stoqeve, obligimeve dhe të arkëtueshmeve.
Rreziku	Procesi i dobët i konsolidimit dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët e kanë reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar brenda MSH-së. Kjo ka rezultuar me shpalosje jo të sakta të informatave financiare në PVF.
Rekomandimi 5	Ministri duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj agjencive ekzekutive përfshirë efikasitetin e procesit të konsolidimit si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike deri më 1 tetor 2016.

2.5.2 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në kornizën e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 6 – Mos-zbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

E gjetura	Pyetësori i vetvlerësimit ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Ministria nuk ka hartuar ndonjë regjistër të rreziqeve dhe aktivitetet nuk menaxhohen në mënyrë aktive për sa i përket sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të zbutur rreziqet.
Rreziku	Mungesa e një rregjistri të rreziqeve do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
Rekomandimi 6	Ministri duhet të sigurojë se është zhvilluar një qasje e re e menaxhimit e cila do të adresonte rreziqet potenciale për mosarritjen e objektivave të MSH-së dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë të stafit – UD i Drejtorit dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MSH-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Auditimet e brendshme kanë përfshirë fusha me rëndësi për veprimtarinë dhe objektivat e organizatës. NjAB ka dokumentuar dhe analizuar problemet dhe ka propozuar zgjidhje për menaxhmentin. Përveç planit të paraparë në Ministri, një auditorë ka participuar edhe në pilot auditimin në Agjencinë për Zhvillim Bujqësorë si pjesë e projektit për KBFP të financuar nga BE-ja.

Çështja 7 – Sistemi i auditimit të brendshëm – Prioriteti i lartë

E gjetura

Ekziston një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB:

1. Vetëm nëntë prej pesëmbëdhjetë raporteve të planifikuara janë kryer;
2. Nuk ka pasur auditim me fokus të veçantë në qeverisje;
3. Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë implementuar vetëm në një numër të vogël të rasteve nga ana e menaxhmentit; dhe

4. Komiteti i Auditimit kishte mbajtur pesë takime gjatë 2015 megjithëse na janë ofruar procesverbalet e vetëm tre takimeve. Për këtë arsye ne nuk ishim në gjendje për të vlerësuar kontributin e tyre.

Rreziku

Një plan i papërfunduar i NjAB-së zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që rezulton me humbje financiare për Ministrinë. Mungesa e kontributit nga KA dhe mos adresimi i rekomandimeve zvogëlon efikasitetin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në përgjithësi.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të sigurohet që përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së të monitorohet çdo tre muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur. Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i NjAB, Ministri duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit. Gjithashtu duhet të rishikohen veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit. Sa i përket MSH-së, realizimi i dobët i projekteve kapitale mbetet një shqetësim. Kjo ka rezultuar në realizimin e dobët të buxhetit. Në kontekst të sistemeve financiare, nevojitet përmirësim tek kontrollet e nivelit të mesëm mbi shpenzimet, me theks të veçantë tek kompenzimi i pagave, menaxhimi i subvencioneve, pasurisë dhe i stokut të barnave.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MSH-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final1	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013[2] Realizimi
Burimet e Fondeve:	**35,495,088**	**37,947,958**	**31,698,422**	**27,420,111**	**99,521,409**
Granti i Qeverisë -Buxheti	32,975,788	31,653,960	31,390,978	26,752,800	95,373,804
Të bartura nga viti paraprak[3] –	0	100	100	387,425	0
Të hyrat vetjake[4]	69,300	69,300	10,149	48,878	3,685,983
Financimet nga Huamarrja	2,450,000	5,050,000	56,737	0	0
Donacionet e jashtme	0	1,174,597	240,459	231,009	461,621

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[2] Realizimi i vitit 2013 I takon Ministrisë së Shëndetësisë bashk me SHSKUK-në.
[3] Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[4] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,452,870€. Ky ndryshim është rezultat i ndryshimeve të buxhetit me vendime të Qeverisë dhe të përfshirjes në buxhetin final të donacioneve të jashtme, kredisë së Qeverisë Austriake për projektin e kardiokirurgjisë, dhe të hyrave.

Në vitin 2015, MSH ka përdorur 84% të buxhet final, me një përmirësim prej 16% krahasuar me vitin 2014. Megjithatë, realizimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**35,495,088**	**37,947,958**	**31,698,422**	**27,420,111**	**99,521,409**
Pagat dhe Mëditjet	6,762,391	7,721,940	7,652,757	6,918,642	44,408,183
Mallrat dhe Shërbimet	11,883,424	10,422,537	9,145,047	8,913,743	38,332,671
Shërbimet komunale	240,548	199,780	195,857	172,515	3,388,643
Subvencionet dhe Transferet	7,703,725	9,730,725	9,714,570	9,683,042	4,763,603
Investimet Kapitale	8,905,000	9,872,975	4,990,190	1,732,169	8,628,309

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 959,549€ është rezultat i shtimit të 20 punëtorëve në Mitrovicë konform marrëveshjes për shuarjen e mbrojtjes civile, kompenzimi i përvojës së punës, dhe kompenzimi për stafin e përfshirë në 'Fondin për Kuadro';
- Zvogëlimi i buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin transferin e shumës prej 1,200,000€ në kategorinë e subvencioneve, për TMJISHP dhe pjesa tjetër e reduktimit të buxhetit ishte bërë me vendime të Qeverisë;
- Zvogëlimi i buxhetit për shpenzimet komunale ishtë bërë me vendim të Qeverisë me qëllim të kursimit;
- Mjetet nga granti qeveritar të planifikuara për investimeve kapitale ishin shpenzuar 100%. Mirëpo "Projekti i Shëndetësisë Kosovare" në vlerë prej mbi 2.4 milion euro i cili ishte planifikuar të financohet nga huaja e Bankës Botërore, ka filluar me implementim vetëm në Shtator 2015, dhe si rezultat është realizuar vetëm 2% e buxhetit. Poashtu projekti i kardiokirurgjisë me vlerë rreth 2.6 milion euro, i planifikuar të financohet nga mjetet e huasë nga Qeveria e Austrisë kishte ngecur në implementim për shkak se marrëveshja e huas ishte në pritje të ratifikimit nga Kuvendi të Kosovës. Edhe disa projekte tjera kapitale[5] nuk janë realizuar sipas planit.

[5] QKMF Kaqanik me vlerë prej 400,000€ , dhe zhvillimi i SISH-it me vlerë 1,000,000€,janë në proces të implementimit, ndërsa Emergjenca në QKUK 1,300,000€dhe QKMF Bare Mitrovicë me vlerë 68,664€, nuk kanë filluar ende.

Tabela3. Të hyrat vetjake – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar[6]	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	69,300	69,400	3,432,782	3,045,358	4,215,387

Të hyrat vetjake gjatë vitit 2015 ishin prej 3,432,782€, nga të cila 10,249 janë shfrytëzuar derisa pjesa tjetër kanë shkuar në buxhetin e shtetit. Totali i të hyrave të inkasuara reflekton një rritje prej rreth 13% krahasuar me vitin paraprak.

Çështja 8 – Keqklasifikimi i shpenzimeve të bëra përmes prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Në MSH, AKPPM, dhe IKSHP, kishte keqklasifikim të shpenzimeve. Shuma prej 72,244[7]€, ishte paguar nga investimet kapitale, ndërsa është dashur të paguhet dhe të regjistrohet në kuadër të mallrave dhe shërbimeve, dhe shuma prej 125,127€[8] e realizuar nga mallrat dhe shërbimet, e që është dashur të bëhet nga investimet kapitale. Këto kanë ndodhur pjesërisht për shkak të keqbuxhetimit të këtyre shpenzimeve.

Rreziku Keqklasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse dhe në paraqitjen jo të drejtë të informatave në PVF.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të sigurojë fillimisht klasifikimin korrekt të shpenzimeve në kërkesat buxhetore në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Kjo mundëson një paraqitje me të qartë në lidhje me natyrën e shpenzimeve të prezantuara në PVF.

[6] Të hyrat e inkasuara që janë planifikuar të shfrytëzohen nga Ministria e Shëndetësisë.
[7]MSH-Mirëmbajtja e modulit të SISHIT-it 17,134€; AKPPM- Furnizim me pajisje të aparaturës LZKPPM 1,474€, furnizim me ulëse për parqe 960€, Furnizim me material shpenzues 19,780€, Servisim i prurjes dhe thithjes 5,107€, Banderolla 5,213€, dhe Sigurimi i ndërtesës 8,847€ IKSHP- Tre pagesa për servisimin dhe mirëmbajtjen e aparaturës 12,842€, Servisim i aparaturës mjekësore 923€.
[8] MSH- Furnizime mjekësore-17,495€, Sond për Bronkoskopi 20,500, Ultratingull 18,195€, Karrige stomatologjike 36,730€ AKPPM- Pajisje tjera 8,945€, Furnzimi me UPS 9,612€, IKSHP- Kompjuter 3,100€, Ventilim 11,000€.

3.4 Prokurimi

Shpenzimet e totale të realizuara përmes procesit të prokurimit në 2015 janë rreth 13 milion euro. Menaxhimi i furnizimeve me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale gjatë vitit 2015 është bërë nga SHSKUK-ja, sa i përket kujdesit dytësor (Spitaleve të Përgjithshme) dhe tretësor (QKUK), derisa Ministria ka menaxhuar vetëm pjesën që ka të bëj me furnizimin e kujdesit parësor (Qendrave të Mjekësisë Familjare). Ne kemi rishikuar procesin e shpenzimeve në MSH, AKPPM, QKTGj dhe në IKSHP. Në përgjithësi në MSH kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efektive në fushën e shpenzimeve përmes prokurimit, megjithatë janë disa mangësi të cilat duhet të adresohen për ta përmirësuar efikasitetin e procesit në tërësi.

Çështja 9 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i mesëm

E gjetura

Me anë të procedurës së kuotimit të çmimeve dhe vlerës minimale janë realizuar 8 blerje të pajisjeve për TI me vlerë totale 30,899€, dhe 4 blerje mobiljesh me vlerë 21,272€.

Në 90% të kontratave të testuara mungonte vendimi formal për emërimin e menaxherit të kontratës dhe nuk kishte raporte rreth realizimit të kontratave. Mungesë të raporteve nga menaxherët e kontratës kishte edhe në QKTGJ.

Rreziku

Mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzuesve përkatës mund të rezultoj me furnizim me çmime jo të favorshme. Ndërsa mungesa e menaxherëve të kontratave respektivisht mungesa e raporteve për realizimin e tyre zvoglon sigurinë që kontratat janë realizuar konform specifikave të parapara.

Rekomandimi 9

Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i brendshëm për çështjet e identifikuara të prokurimit, në të cilat rregullat dhe udhëzuesit nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Bazuar në ketë rishikim, të ndërmerren masat e nevojshme që mundësojnë shmangien e mangësive të tilla në të ardhmen.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avancet, Komunalitë, etj.

Në këtë kategori përfshihen shpenzimet e ndodhura që nuk kanë nevojë për zhvillim të procedurave të prokurimit, si drekat zyrtare, komunalitë, avancet për udhëtime jashtë vendit etj

Çështja 10 – Mos mbyllja e avanceve – Prioritet i mesëm

E gjetura Në PVF janë paraqitur avanse të pa mbyllura për udhëtimet zyrtare në vlerë prej 52,650€. Shkaku kryesor për mos mbylljen me kohë, ishte neglizhenca e zyrtarëve për të sjell dëshmitë për shpenzimet e ndodhura, dhe mungesa e një mekanizimi që do të detyronte arsyetimin e tyre.

Rreziku Vonesat në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve të pashpenzuara.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të siguroj që të zbatohen me përpikëri politikat dhe procedurat e kërkuara me rastin e udhëtimeve zyrtare, duke dëshmuar dhe arsyetuar saktë shpenzimet e ndodhura dhe duke mbyllur me kohë avanset.

Çështja 11 - Keqklasifikim i shpenzimeve jo përmes prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura MSH ka paguar rreth 70,000€ nga buxheti për Mallra dhe Shërbime për Edukimimin e Vazhdueshëm Profesional (EVP) të stafit shëndetësorë të Shërbimit Spitalorë Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK). Kjo formë e financimit është trashëguar nga vitet e kaluara kur SHSKUK ishte pjesë e MSH-së dhe financimi i tyre nga mallrat dhe shërbimet ka qenë në rregull. Mirëpo pas ndarjes së tyre në dy OB të ndryshme, financimi i stafit të SHSKUK do të duhej të bëhet nga kategoria e subvencioneve.

Në AKPPM pagesat për shërbime të ndryshme me vlerë të përbashkët prej 10,527€, janë paguar nga buxheti i planifikuar për shpenzime komunale.

Rreziku Pagesa e shërbimeve nga buxheti i shpenzimeve nga kategoritë jo adekuate shkakton pasqyrim jo real të shpenzimeve në pasqyrat financiare duke mbivlerësuar njërën, dhe nënvlerësuar kategorinë tjetër të shpenzimeve.

Rekomandimi 11 Ministri dhe Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së duhet të sigurojnë që të gjitha pagesat dhe shpenzimet të realizohen në përputhje me planifikimet paraprake, dhe të regjistrohen konform planit të aprovuar kontabël.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. MSH për vitin 2015 për paga dhe mëditje kishte shpenzuar 7,652,757€ apo 99% të buxhetit final. Menaxhimi i personelit dhe zbatimi i kontrolleve në këtë fushë të shpenzimeve nuk ishin të kënaqshme.

Çështja 12 – Mbajtja e pozitave kyçe me ushtrues detyre dhe si punë sekondare - Prioritet i lartë

E gjetura Tetë pozita kyçe në MSH-së dhe dy në AKPPM, mbahen me ushtrues detyre, me kohëzgjatje më shumë se përcaktohet me ligj. Duhet theksuar se në MSH, gjashtë prej këtyre pozitave janë në proces të rekrutimit.

Në IKSHP janë 13 pozita udhëheqëse që vazhdojnë të mbahen si punë sekondare. Personat në fjalë realizojnë pagë primare në një organizatë tjetër buxhetore.

Rreziku Ushtrimi i detyrës në periudhë më të gjatë se tre muaj, është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe mund të rezultojë me përfomancë të ulët operacionale. Pozitat menaxheriale me pagë sekondare poashtu shkaktojnë rezultate jo të mira në punë pasi për udhëheqjen e pozitave drejtuese kërkohet angazhim i plotë kohor.

Rekomandimi 12 Ministri dhe drejtori i IKSHP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.

Çështja 13 - Angazhimi me kontrata mbi vepër për pozitat e rregullta të punës – Prioriteti i lartë

E gjetura Në AKPPM, gjatë vitit 2015 në 12 pozita të rregullta ishin angazhuar punonjës me kontrata mbi shërbimet e veçanta, të cilët janë angazhuar pa procedura të rregullta të rekrutimit.

Rreziku Angazhimi i punonjësve me kontrata mbi shërbimet e veçanta, minimizon konkurencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara. Derisa tejkalimi i kohëzgjatjes së këtyre kontratave më shumë se 6 muaj është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të inicojë një rishikim gjithpërfshirës të stafit të angazhuar me marrveshje për shërbime të veçanta për të përcaktuar saktë nevojat për staf në AKPPM, dhe të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.

Çështja 14 –Pagesa e bordeve dhe komisioneve- Prioritet i mesëm

E gjetura Pagesat për borde dhe komisione në MSH për vitin 2015 (përfshirë edhe dhjetorin 2014) ishin 370,550€. Edhe më tej vazhdon të përseritet pjesëmarrja e zyrtarëve të njëjtë në më shumë së një komison apo bord.

Në AKPPM, kompenzimet për borde dhe komisione në vitin 2015 ishin 60,704[9]€. Shumica e anëtarëve të komisioneve janë punëtorë të AKPPM-së, dhe shumica e takimeve mbahen brenda orarit të rregullt të punës, përderisa në vendimet për themelimin e disa prej tyre kërkohet që takimet të mbahen pas orarit të rregullt.

Rreziku Pagesat për borde dhe komisione për zyrtarët specifik janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që nuk lejohet pjesëmarrja në më shumë së një bord apo komision. Kjo mund të shkaktojë pagesa të parregullta dhe dëmtim eventual të buxhetit. Përveç kësaj angazhimi në borde/komisione gjatë orarit të punës rrit rrezikun që zyrtarët të mos i kryejnë obligimet e tyre ditore si rezultat i angazhimit në detyra tjera.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të iniciojë zhvillimin e një politike të re rreth funksionimit të bordeve dhe komisioneve duke specifikuar në mënyrë të qartë udhëzimet rreth angazhimit, punës dhe kompensimit të anëtarëve të bordeve dhe komisioneve të ndryshme.

Çështja 15 –Kompenzimi i kujdestarive për mjekët e SHSKUK-së - Prioritet i mesëm

E gjetura MSH ka bërë kompenzimin e kujdestarive për 24 mjekë specialist të cilët janë në marrëdhënie pune me SHSKUK-në që tani është OB e veçantë. MSH nuk e kishte të planifikuar e as proceduar kompenzimin e kujdestarive për këta 24 mjekë specialist. Procedimi i pagesave është bërë nga Ministria e Administratës Publike, derisa listat janë dërguar nga SHSKUK-ja. Vlera e kompenzimit të këtyre kujdestarive ishte 28,323€.

Rreziku Kompensimi i stafit i cili nuk është staf i MSH-së rezulton me shpenzim të pa arsyeshëm të buxhetit dhe ndikon negativisht në planin e shpenzimeve duke qenë se mjetet e planifikuara për qëllime tjera shfrytëzohen për kompensimin e kujdestarive të mjekëve specialist.

Rekomandimi 15 Ministri së bashku me drejtorin e përgjithshëm të SHSKUK-së duhet të shqyrtojnë mundësinë që kompensimi për pagat dhe kujdestaritë e këtyre mjekëve specialist të bëhet nga buxheti i SHSKUK e jo nga Ministria.

[9] Komisionet e brendshme-13,799€
Komisionet e jashtme-46,905€

Çështja 16 – Kalkulimi i kujdestarive-Prioritet i mesëm

E gjetura

Kemi evidentuar disa mangësi dhe gabime ne kalkulimin e kompensimeve për ndërrimet e natës në Shërbimin Shëndetësore të Burgjeve. Kompensimet nuk janë bërë sipas Ligjit te punës dhe kontratës kolektive ngase kompensimi i ndërrimeve të natës gjatë vikendeve ishte bërë me normë prej 30% në vend të 50% sa realisht duhet. Ndërsa kalkulimi i çmimit për orë punë si për mjekë ashtu edhe infermier është i njëjtë përkundër gradave të ndryshme.

Në QKTGJ, nuk janë bërë planifikime të sakta mujore të kujdestarive, pasi që ato dallojnë me kujdestaritë e mbajtura dhe të kompenzuara. Në mungesë të evidencave, janë bërë zëvendësime mes stafit, si dhe stafi shëndetësorë nuk nënshkruhet individualisht në librat e kujdestarive.

Lista e kujdestarive në QKTGJ përmban edhe zyrtarë të administratës qendrore për punë të cilat nuk janë kujdestari.

Rreziku

Planifikimi jo i mirë, mungesa e evidencave dhe kalkulimi jo i drejtë i kujdestarive dhe ndërrimeve të natës mund të ndikojë që të ketë pagesa të parregullta. Ndryshimet e paevidentuara të orareve mund të ndikojnë cilësinë e shërbimeve.

Rekomandimi 16

Ministri nëpërmjet drejtorit të QKTGj-së duhet të sigurojë që aplikohen kontrolle monitoruese ndaj procesit të planifikimit, aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive, në mënyrë që kompensimet të jenë të bazuara në ditarët e kujdestarive. Ndryshimet eventuale të planit duhet paraprakisht të aprovohen.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Gjatë vitit 2015 për subvencione ishin shpenzuar 9,714,570€, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve përdoren për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore. Zbatimi i kontrolleve menaxheriale në këtë fushë të shpenzimeve nuk ishte në nivel të kënaqshëm.

Çështja 17–Subvencionim i specializantëve në kundërshtim me marrëveshjet - Prioritet i lartë

E gjetura MSH kishte nënshkruar marrëveshje për subvencionim, me mjekët në shkollim specialistik me vetëfinancim. Këto marrëveshje ju mundësonin atyre që përveç kontratave të rregullta në QKUK, të kenë angazhim shtesë prej 8 orë punë në javë në kujdesin primar. Për të qenë përfitues të subvencionit Ministria i ka kushtëzuar specializantët që të nënshkruajnë nga një deklaratë me anë të së cilës ata zotohen se përveç kontratës bazë dhe 8 orëve në kujdesin primar, nuk do të kenë angazhime tjera. Ne kemi gjetur se 121 specializantë/përfitues gjatë vitit 2015 kanë punuar edhe në institucione tjera publike/private. Kjo ka rezultuar me pagesa në kundërshtim me marrëveshjet dhe dëmtim të buxhetit për 799,451€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mekanizmave për monitorimin dhe verifikimin e të ardhurave të specializantëve përfitues.

Rreziku Subvencionimi i specializimeve në kundërshtim me marrëveshjet, përveç që ka shkaktuar dëmtim të buxhetit, rrit rrezikun të dëmtohet edhe reputacioni i institucionit dhe profesionit në përgjithësi.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të sigurojë që të nderpritet mbështetja financiare për specializantët e identifikuar që kanë përfituar në kundërshtim me marrëveshjet dhe të shqyrtohen mundësitë ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të përfituara në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara. Përveç kësaj duhet të vendoset bashkëpunim me institucionet relevante (ATK dhe Trustin) për të verifikuar nëse ka edhe specializantë tjerë që punojnë/përfitojnë të ardhura në institucione private dhe kanë përfituar subvencionim nga MSH.

Çështja 18 – Mangësi në menaxhimin e Subvencioneve për TMJIPSH - Prioritet i lartë

E gjetura

Testimet tona kanë vërejtur se menaxhimi i subvencioneve vazhdon të ketë dobësi. Disa nga dobësitë prcedurale të vërejtura gjatë auditimit janë:

- Pagesat për TMJIPSH vazhdojnë të bëhet bazuar në profatura[10]. Pas trajtimit, pacientët nuk i kanë sjellë dëshmitë për marrjen e shërbimeve respektivisht faturat përkatëse për ti arsyetuar shpenzimet.

- Në dy raste, zyra e TMJIPSH kishte proceduar aplikacionet e palëve në mungesë të pro faturave nga institucionet private shëndetësore, dhe kjo është në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit administrativ 10/2013. Në dy raste tjera vetëm dy nga tre mjekët e komisionit konziliar kishin nënshkruar raportin,[11] edhe pse UA përcakton që ky raport duhet të nënshkruhet nga tre mjek.

- Kërkesat e pacientëve për TMJISHP nuk shqyrtohen nga Bordi Ekzekutiv sipas datës së arritjes së kërkesave. Në disa raste shqyrtimi dhe ekzekutimi i kërkesave ka përfunduar nga 1 deri 2 muaj, ndërsa në disa raste kjo procedurë zgjaste 6 deri 10 muaj.

- Trajtimi i pacientëve të subvensionuar nga MSH bëhet në rreth 100 Institucione Private Shëndetësore (IPSH) brenda dhe jashtë Kosovës. Në vitin 2015 MSH ka bërë 5 barazime financiare me institucionet private për subvencionet e dhëna gjatë vitit 2014, ndërsa me një institucion privat barazimi ishte bërë për tërë pacientët e trajtuar gjatë viteve. Nga këto barazime kanë rezultuar rreth 250,000€ të pa shfrytëzuara. Do të thotë që mjetet janë paguar por nuk janë marrë shërbimet nga pacientët. Pas këtyre barazimeve këto mjete janë ridestinuar/shfrytëzuar për trajtimin e pacientëve tjerë.

Rreziku

Mungesa e një politike të qëndrueshme për arsyetimin e shpenzimeve për TMJIPSH dhe shqyrtimi i kërkesave në kundërshtim me rregullat në fuqi ndikon në menaxhimin jo efektiv të subvencioneve duke krijuar pagesa potencialisht të parregullta, dhe rrezikon qe pacientët jo meritorë të përfitojnë. Shqyrtimi me vonesë i kërkesave mund të ndikojë që pacientët të mos marrin trajtimin me kohë. Derisa mos barazimet me institucionet shëndetësore ka bërë që mjetet e paguara të mbeten të pashfrytëzuara, përderisa në kohën e njëjtë shumë pacientë në nevojë kanë mbetur pa përfituar me arsyetimin e mungesës së mjeteve.

[10] Sipas UA aplikacionit duhet bashkangjitur pro-fatura nga institucioni shëndetësor me të cilin Ministria nuk ka marrëveshje të bashkëpunimit në kuadër të PJIP

[11] Raporti I Komisionit Konziliar - është dëshmia se pacineti me diagnozen e vërtetuar nga mjekët e Komisionit Konziliar nuk mund të trajtohet brenda institucioneve shëndetësore publike në vend në momentin e referimit.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të sigurohet se subvencionet paguhen pas nënshkrimit të një marrëveshje formale në mes të MSH-së dhe përfituesit, ku qartësohen obligimet e të dy palëve. Gjatë zhvillimit të procedurave të aplikimit dhe shqyrtimit të tyre duhet të respektohen kërkesat ligjore. Përveç kësaj Ministri duhet të iniciojë krijimin e një rregullore/udhëzimi për të përcaktuar përgjegjësitë e MSH dhe marrëdheniet me institucionet shëndetësore private duke specifikuar në mënyrë të qartë kërkesat për raportim financiar dhe në lidhje me shërbimet e ofruara.

Çështja 19 – Subvencionimi i pacientëve me barna– Prioritet i lartë

E gjetura Në gjashtë raste ishin subvencionuar barna nga lista esenciale LE (kryesisht citostatik) me vlerë prej 9,070€, përderisa do të duhej të siguroheshin nga Institucionet shëndetësore përmes kontratës/prokurimit nga mallrat dhe shërbimet. Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të LE.

MSH kishte shpenzuar rreth 510,000€ për subvencionimin e barnave. Këto mjete u paguhen direkt barnatoreve, ku furnizohen pacientët, mirëpo nuk ka ndonjë mekanizëm i cili vërteton/siguron që pacientët vërtet janë furnizuar me ato barna.

Rreziku Mungesa e një mekanizmi i cili do të vërtetonte furnizimin e pacientëve me barnat e subvencionuara, rritë rrezikun që Ministria të paguaj për barnat të cilat pacientët mund të mos i kenë marrë. Përveç kësaj, menaxhimi i dobët furnizimit me barnat e Listës Esenciale ka ndikuar (edhe pse jo materialisht) në zvoglimin e fondit për TMJIPSH duke shfaqur nevojën e subvencionimit të pacientëve me barna të cilat është dashur të sigurohen nga institucionet shëndetësore.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të shqyrtoj mundësinë e krijimit të një mekanizmi adekuat që do të siguronte se barnat e subvencionuar kanë arritur tek pacientët e synuar. Poashtu Ministri së bashku me AFSH-në duhet të shtojnë kontrollet për të siguruar që kontratat për furnizim me barnat e LE menaxhohen në mënyrë efektive dhe që të ketë furnizim të rregullt me barna nga LE.

Çështja 20–Subvencionet e pa arsyetuara nga përfituesit-Prioritet i mesëm

E gjetura MSH ka subvencionuar shoqatat e ndryshme profesionale në ofrimin e mundësive për EVM të profesionistëve shëndetësorë. Mjetet financiare të ndara për këta përfitues janë rreth 65,000€. Përkundër se është kërkesë e UA 01/2013, shoqatat nuk kishin raportuar për ecurinë financiare dhe operative të EVM-së. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mekanizmave që do ti detyronte përfituesit të raportonin për arsyetimin e mjeteve të përfituara.

Rreziku Mos arsyetimi i plotë i shpenzimeve për Edukim të Vazhdueshëm Mjekësorë rrit rrezikun që mjetet të mos shfrytëzohen konform qëllimeve të aprovuara.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të siguroj që programet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave për raportimin e mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve. Po ashtu, mos të vazhdojë subvencionimi i shoqatave profesionale për EVM përderisa nuk i arsyetojnë shpenzimet e mjeteve financiare të përfituara nga MSH.

3.6 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga MSH në 2015 ishin në vlerë 3,432,782€. Këto të hyra përbëhen nga: të hyrat nga licencat për institucione shëndetësore, të hyrat nga licencat për produkte medicinale, participimet nga pacientët, gjobat e inspektoratit etj. Procesi i barazimit ishte bërë me kohë me të gjitha institucionet që gjenerojnë të hyra.

Çështja 21 – Mangësi në menaxhimin e të hyrave – Prioritet i lartë

E gjetura Ministria nuk posedon softuer për regjistrimin, klasifikimin dhe raportimin e të hyrave. Të dhënat manuale ekzistuese menaxhohen dobët. Procedimi manual i informatave për të hyrat me institucionet e MSH-së mund të sjell deri tek gabimet dhe marrjen e vendimeve në mungesë të informatave të sakta.

Të hyrat në AKPPM regjistrohen në një databazë të brendshme, por të dhënat nuk barazohen me shënimet në SIMFK. Derisa për qëllime të raportimit janë prezantuar të dhënat nga SIMFK.

Rreziku Procedimi manual i informatave për të hyrat me institucionet e MSH-së mund të sjell deri tek gabimet dhe mungesa e saktësisë së të dhënave mund të ndikojë në procesin mbikqyrës dhe vendimmarrës.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të sigurojë që të funksionalizohet moduli për të hyra në kuadër të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), i cili do mbështeste mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Po ashtu, kryeshefi i AKPPM-së duhet të sigurohet që regjistrat e brendshëm për të hyrat të jenë të sakta dhe të harmonizohen me SIMFK-në. Kjo do të mundësonte shpalosjen e informatave të sakta në PVF.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik dhe të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Në pasqyrat financiare MSH ka paraqitur pasuri kapitale me vlerë neto prej 1,840,243€. Derisa gjatë vitit MSH kishte shpenzuar për investime kapitale shumën prej 4,990,190€ (përfshirë shpenzimet e institucioneve nën menaxhimin e Ministrisë). Informatat në lidhje me pasuritë janë menaxhuar dobët dhe regjistri kontabël nuk reflekton gjendjen reale të pasurisë.

Çështja 22 – Menaxhimi i dobët i regjistrave të pasurisë- Prioritet i lartë

E gjetura

MSH dhe programet vartëse nuk kanë ndonjë politikë të brendshme në lidhje me menaxhimin e pasurisë. Informatat në lidhje me pasuritë fikse në SIMFK dhe raportet e inventarizimit nuk ishin të sakta ngase dallonin nga gjendja faktike e pasurive. Derisa pasuritë e blera gjatë vitit 2015 nuk ishin regjistruar në SIMFK. Edhe në AKPPM dy pagesa me vlerë 8,945€ nuk ishin regjistruar në evidencat e pasurisë mbi 1,000€.

Përveç kësaj në regjistrin e pasurisë me vlerë mbi 1,000€ ka raste kur është llogaritur zhvlerësimi për tokën derisa ajo nuk zhvlerësohet. Poashtu ka raste kur për pasuritë kapitale të blera në vitet e mëhershme nuk është llogaritur zhvlerësimi.

E gjithë kjo ka ndodhur për shkak të mos aplikimit të udhëzimeve dhe rregulloreve që kanë shkaktuar nënvlerësim material të vlerës së pasurive të shpalosur në PVF për mbi 2.2 milion euro.

Rreziku

Mungesa e informatave të sakta rreth pasurisë, pengon menaxhimin efektiv të tyre dhe vështirëson aplikimin e kontrolleve adekuate. Kjo poashtu vështirëson vendim-marrjen në lidhje me investimet në pasuri si dhe tek parashikimet buxhetore. Keq prezantimi i pasurive në PVF ndikon në theksimin e çështjes.

Rekomandimi 22

Ministri duhet të iniciojë një rishikim për të përcaktuar pse rregullat dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e pasurisë, nuk janë aplikuar dhe të përcaktojë masat e nevojshme për menaxhimin më mirë të tyre . Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen në vazhdimësi për të siguruar shpalosjen e vlerës së tyre të sakt në PVF duhet të shpaloset në PVF.

3.7.2 Menaxhimi i Barnave

Shpenzimet për blerjen e barnave gjatë vitit 2015 arrijnë vlerën 5,396,190€. Kjo është një fushë mjaft e ndjeshme për Ministrinë. Në vitin 2015 Departamenti farmaceutik i MSH-së ishte përgjegjës për furnizimin me barna për kujdesin primarë, derisa SHSKUK-ja për kujdesin sekondar dhe terciar. Shënimet në lidhje me furnizimet nga lista esenciale evidentohen në Sistemin për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik (SMSF).

Çështja 23 – Menaxhimi i dobët i stokut farmaceutik - Prioritet i lartë

E gjetura Informacionet në SMSF nuk ofrojnë siguri për arsye se gjendja reale dallon shumë nga të dhënat në sistem.

Salldo fillestare e Stokut Farmaceutik në 2015 ishte për 23,640€ më e lartë se salldo përfundimtare e vitit 2014. Barnat e blera në vlerë 11,358€ nuk ishin regjistruar fare në SMSF. Poashtu për disa blerje të barnave në SMSF janë evidentuar vetëm hyrjet përderisa evidentimi i daljeve është bërë manualisht. Kjo ka ndikuar që informatat në lidhje me gjendjen e stokut përfundimtar të barnave për vitin 2015 të mos jenë të sakta dhe të besueshme. Në PVF është paraqitur salldo përfundimtare e SMSF, dhe nuk janë reflektuar daljet e realizuara manualisht.

Rreziku Menaxhimi i dobët i evidencave dhe bartja e gabuar e salldove ndikon që informatat rreth stoqeve të mos jenë të sakta, dhe gabimet në vlera të reflektohen edhe në PVF. Kjo poashtu do të ndikoj në modifikimin e opinionit të auditimit apo theksimin e çështjes.

Rekomandimi 23 Ministri duhet të kërkojë një rishikim të kualitetit të informatave rreth stokut farmaceutik dhe mënyrës së përdorimit të SMSF-së, për të përcaktuar masat e nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të tij. Sigurimi i informatave të sakta të stokut farmaceutik mundëson menaxhim më të lehtë dhe eviton mundësinë e theksimit të çështjes ose modifikimit të opinionit për PVF.

3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

MSH nuk ka arritur ti arkëtoj të gjitha tarifat për shërbimet e ofruara. Sipas PVF saldo e të arkëtueshmëve ishte 230,837€. Ne testuam faturat e lëshuara dhe të pa arkëtuara nga Inspektorati Shëndetësor (ISH), IKSHP-së, dhe Inspektorati Farmaceutik.

Çështja 24 – Mos prezentimi i Llogarive të Arkëtueshme në PVF-Prioritet i mesëm

E gjetura Gjobat e Inspektoriatit Farmaceutik në vlerë prej 58,000€ nuk janë shpalosur në PVF si të arkëtueshme.

Rreziku Mungesa e qasjes së duhur për mbledhjen e të arkëtueshmeve mund të rezultojë në fonde të pamjaftueshme për realizimin e shpenzimeve të planifikuara nga të hyrat vetjake. Mos shpalosja e të arkëtueshmeve në PVF zvogëlon cilësinë e raportimit dhe jep pamje jo të saktë të informacioneve.

Rekomandimi 24 Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës sa i përket qasjes ndaj llogarive te arkëtueshme duke i identifikuar pengesat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes së të hyrave. Duhet të mbahen evidenca të sakta në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe informatat nga këto evidenca të shpalosen në PVF.

3.7.4 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015, të paraqitura në PVF ishte 168,320€. Këto detyrime janë bartur për t"u paguar në vitin 2016.

Çështja 25 – Shpalosja jo e plotë e obligimeve të papaguara- Prioritet i mesëm

E gjetura

Jo të gjitha obligimet ishin shpalosur në PVF. Subvencionet e TMJIPSH-së të aprovuara nga bordi në vlerë prej 38,700€, kanë mbetur si obligim për vitin 2016, dhe obligimet e AKPPM-së me vlerë 1,324€ nuk ishin shpalosur në PVF.

Ministria nuk ka aplikuar një proces të mirëfilltë të mbledhjes së faturave prej Institucioneve vartëse, të cilat pastaj raportohen si obligime të papaguara. Kjo shpie në mosnjohje dhe mospagesë të obligimeve me kohë. Si pasojë e mospagesës me kohë të faturave, gjatë vitit 2015 thesari kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 37,866€.

Rreziku

Prezantimi jo i plotë i obligimeve ndikon në cilësinë e informatave të shpalosura në PVF. Mungesa e informatave të sakta në lidhje me obligimet ndikon në planifikim të kërkesave buxhetore, krijon vështirësi financiare dhe ndikon në mos realizim të objektivave duke marrë parasysh se detyrimet duhet të financohen nga mjetet e parapara për projektet aktuale.

Rekomandimi 25

Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e kësaj çështje. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore, dhe pagesat të bëhen sipas limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna[12]	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
Pasqyrat Financiare	**Rekomandimi 1** - Ministri duhet të sigurojë që plani buxhetor të identifikojë saktë shpenzimet sipas kategorive adekuate, në mënyrë që të ketë pasqyrim të saktë të aktiviteteve financiare të Ministrisë. Për më tepër procesi i konsolidimit duhet të përfshijë një rishikim kritik të PVF-ve nga menaxhmenti para se draft PVF të dërgohen në Thesar. Deklarata e bërë nga ZKA/ZKF, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhen vetëm pas shqyrtimit gjithëpërfshirës dhe kritik në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.		I adresuar por i paimplementuar plotësisht. Është hartuar një qarkore për hartimin e PVF-ve ku parashihet edhe rishikimi i tyre nga menaxhmenti por, në PVF sërish kanë ndodhur gabime. Poashtu sërish kishte keqklasifikim të shpenzimeve.	
Rekomandimet e vitit paraprak	**Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë një rishikim të planit të veprimit për të përcaktuar qartë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, dhe stafin përgjegjës për veprimet e kërkuara. Fokusi fillestar duhet të jetë në fushat e rëndësisë më të madhe. Përveç kësaj zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në baza të rregullta, në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen barrierat që ndikojnë në mos përmirësimin e proceseve dhe aktiviteteve.			I pa adresuar - nuk ka ndodhur ndonjë rishikim i planit dhe implementimi i rekomandimeve nuk ishte në nivelin e duhur.
Qeverisja e Mire	**Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë monitorim të afërt të implementimit të strukturave të reja shëndetësore duke siguruar që linjat e raportimit dhe llogaridhënies janë dizajnuar dhe implementuar si duhet. Dobësitë aktuale duhet të zbuten nga një			I pa adresuar

[12] Rekomandimet 9,10,17,18 të vitit 2014 janë të SHSKUK-së

	sistem i fortë dhe transparent, me ndarje të duhur të detyrave, të kuptuar plotësisht nga menaxheret në të gjitha nivelet.			
Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	**Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë informata cilësore nga strukturat themelore të sistemit shëndetësor si bazë për monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore. Duhet të identifikohen dhe adresohen barrierat për të planifikuar nivelet e realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, ose nuk janë më të vlefshme, kjo duhet adresohet në rishikim buxhetor të mes vitit dhe të reflektohet pozitën e buxhetit final.		Hartohen raporte mujore rreth shpenzimeve. Megjithatë nuk ka dëshmi të mjaftueshme se janë diskutuar mos perputhjet me planin e shpenzimeve dhe masat për tejkalimin e barierave.	
Të hyrat	**Rekomandimi 5** Ministri duhet të sigurojë se janë shqyrtuar të gjitha mundësitë teknike dhe profesionale që në kuadër të SISH-it të funksionalizohet moduli i të hyrave. Veç kësaj kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së duhet të zbatojë mekanizma të kontrollit që mundësojnë koordinimin e informatave në mes të departamenteve që krijojnë të hyra dhe departamentit të financave për të pasur informata të sakta për të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme.		Pjesërisht e adresuar- Nuk është funksionalizuar moduli i të hyravë në SISH. Sa i përket, AKPPM-së është krijuar një databazë e mbrendshme për të hyrat e krijuara.	
Shpenzimet-Prokurimi	**Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojë që drejtori i prokurimit kryen një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit. Përveç kësaj, duhet të zhvillohen procese dhe kontrolle më të mira për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar. Njëjtë duhet të veprojë edhe drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, në lidhje me çështjet e identifikuara në institucionet që janë nën menaxhimin e tij.	Eshtë implementuar sa i përket Ministrisë së Shëndtësisë, ndërsa rekomandimi për SHSKUK do të shqyrtohet në raportin e ndarë për SHSKUK.		

Shenzimet - Prokurimi	**Rekomandimi 7** Ministri duhet të sigurojë që kjo problematike të përcillet duke filluar nga procesi i buxhetimit në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen në kategoritë adekuate për të ofruar një pamje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.			I pa adresuar. Edhe ketë vit janë identifikuar keqklasifikim të shpenzimeve.
Shpenzimet jo përmes prokurimit	**Rekomandimi 8** Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së duhet të sigurojë që të gjitha pagesat dhe shpenzimet të realizohen në përputhje me planifikimet paraprake, dhe të regjistrohen konform planit të aprovuar kontabël.			I pa adresuar , Shpenzimet nuk realizohen në përputhje me planifikimin dhe nuk regjistrohen konfrom planit kontabël
Kompensimet(pagat dhe mëditjet)	**Rekomandimi 11** Ministri, drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së dhe drejtori i IKSHP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe në me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.			I pa adresuar, Në MSH janë evidentuar raste të pozitave me ushtrues detyre, dhe në IKSHP pozitat kyqe menaxheriale me paga sekondare.
Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	**Rekomandimi 12** Ministri duhet të sigurojë aprovimin e organogramit të ri konform nevojave aktuale. Për plotësimin e pozitave të rregullta të punës të zhvillohen procedura të rregullta të rekrutimit. Edhe zëvëndësuesit në QKUK dhe në Spitalet e Përgjithshme duhet të rekrutohen në bazë të konkursit të rregullt konform parimeve të Ligjeve të aplikueshme.			I pa adresuar- në AKPPM numri i pozitave të rregullta me kontrata mbi shërbime të veqanta është 12. Ndërsa , rastet në SHSKUK do të shqyrtohen në raportin e auditimit të SHSKUK-së
Kompensimet(pagat dhe mëditjet)	**Rekomandimi 13** Ministri duhet të sigurojë që Kryeshefi i AKPPM-së ti adresojë këto çështje, dhe të shqyrtohen mundësitë ekziztuese ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të paguara tepër.			I pa adresuar

Kompensimet(pagat dhe mëditjet)	**Rekomandimi 14** Ministri duhet të iniciojë zhvillimin e një politike të re duke specifikuar në mënyrë të qartë parimet udhëzuese për anëtarët në bordet dhe komisionet në sektorin e shëndetësisë, bazuar në parimet e përgjithshme në lidhje me këko aranzhime. Të konsiderohet mundësia e përcaktimit të numrit të takimeve të bordeve dhe komisioneve si dhe çështjeve që do të shqyrtohen brenda takimit.			I pa adresuar
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 15** Ministri duhet të sigurojë që një marrëveshje formale nga MSH-ja dhe përfituesi i paraprinë dhënies së subvencioneve për trajtime mjekësore duke qartësuar obligimet e të dyja palëve. Njëherit duhet të bëhen barazimet me të gjitha spitalet ku janë trajtuar pacientët, për të përcaktuar nëse ekzistojnë parapagime, dhe nëse po mjetet e tilla të ri-destinohen.	Pjesa e parë e rekomandimit është implementuar, ndërsa pjesa e dytë vetëm pjesërisht.		
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 16** Ministri duhet të iniciojë krijimin e një rregullore/udhëzimi duke përcaktuar përgjegjësitë e MSH dhe marrëdheniet në mes institucioneve shëndetësore publike dhe private duke specifikuar në mënyrë të qartë kërkesat për raportim financiar dhe në lidhje me shërbimet e ofruara.			I pa adresuar
Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	**Rekomandimi 19** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të rregullave dhe procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë në sektorin e shëndetësisë. Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen në vazhdimësi dhe vlera e saktë e pasurive duhet të shpaloset në PVF.			I pa adresuar- Nuk janë azhurnuar regjistrat dhe nuk ka rregulla të brendshme për menaxhim të pasurive.
Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	**Rekomandimi 20** Ministri duhet të sigurojë që janë shfrytëzuar të gjitha mekanizmat ligjore për kthimin e pasurive nga ana e anëtarëve të kabinetit të kaluar dhe nga stafi tjetër i larguar nga puna.		I adresuar, por vetëm pjesërisht i implementuar.	

Menaxhimi i barnave	**Rekomandimi 21** Ministri duhet urgjentisht të iniciojë aplikimin e plotë të SMSF-së përgjatë procesit të furnizimit dhe distribuimit të barnave dhe materialit nga lista esenciale. Kualiteti i informatave në sistem duhet të rishikohet. Kjo do të mundësonte menaxhim më të lehtë dhe pasqyrë më të saktë në lidhje me gjendjën e stokut farmaceutik. Vlerat e sakta të stokut farmaceutik duhet të shpalosen në PVF për të shmangur modifikimin e opinionit apo theksimin e çështjes në PVF 2015.		I adresuar por vetëm pjesërisht i implementuar. Ngase cilësia e informatave nuk është shumë e mirë dhe vlerat e shpalosura të stoqeve të barnave në PVF nuk janë të sakta.	
Trajtimi i të arkëtueshme	**Rekomandimi 22** Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës sa i përket qasjes ndaj llogarive te arkëtueshme duke i identifikuar pengesat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes së të hyrave. Duhet të mbahen evidenca të sakta në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe informatat nga këto evidenca të shpalosen në PVF.			I pa adresuar Nuk janë shpalosur në PVF llogaritë të arkëtueshmë të Inspektoriatit Farmaceutik
Trajtimi i borxheve	**Rekomandimi 23** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e kësaj çështje. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore, pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare dhe në PVF të shpalosen vlerat e sakta të detyrimeve.		I adresuar por jo plotësisht i implementuar. Është diskutuar shumë në nivel të ministrisë rreth detyrimeve, por në PVF ka mangësi tek shpalosjet e detyrimeve.	
Sistemi i auditimit të brendshëm	**Rekomandimi 24** Ministri duhet të iniciojë ristrukturimin e burimeve të auditimit të brendshëm me qëllim të përshtatjes me strukturat e reja të sektorit shëndetësor. Si pikënisje për këtë mund të merren propozimet që AP I kishte bërë ministrit të kaluar.			I pa adresuar